



MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E KONTROLLIT TË BRENDSHËM
FINANCIAR PUBLIK DHE RAPORTIMIT FINANCIAR
DREJTORIA E HARMONIZIMIT TË MENAXHIMIT FINANCIAR, KONTROLLIT
DHE KONTABILITETIT

RAPORT
VLERËSIMI I CILËSISË SË SISTEMIT TË
KONTROLLIT TË BRENDSHËM

DREJTORIA E HARMONIZIMIT TË MENAXHIMIT
FINANCIAR, KONTROLLIT DHE KONTABILITETIT
NË INSTITUCIONIN E INSPEKTORIT TË LARTË TË
DREJTËSISË

Tiranë, 2025

PËRMBAJTJA

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	3
II. HYRJA.....	4
III. METODA E VLERËSIMIT.....	5
IV. GJETJET.....	6
4.1 MJEDISI I KONTROLLIT	6
4.2 MENAXHIMI I RISKUT	8
4.3 AKTIVITETET E KONTROLLIT	9
4.4 INFORMACIONI DHE KOMUNIKIMI.....	10
4.5 MONITORIMI	11
V. REKOMANDIMET	11

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Bazuar në nenin 25 dhe 26 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe Kontabilitetit (DH/MFKK) është përgjegjëse për monitorimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë e qeverisjes së përgjithshme. Me qëllim përmirësimit të standardeve të punës si dhe analizimin dhe vlerësimin me detaje të gjendjes së sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësitë e qeverisjes së përgjithshme dhe dhënien e rekomandimeve për adresimin e mangësive të identifikuara, në zbatim të ligjit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, është hartuar Metodologjia për Vlerësimin e Cilësisë së Sistemit të Kontrollit të Brendshëm në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme, miratuar me urdhër të Ministrit të Financave nr.311, datë 23.12.2020 të ndryshuar me urdhër nr.159, datë 18.10.2024. Në këtë kuadër, DH/MFKK ka planifikuar realizimin e procesit të vlerësimit të cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm në disa njësi të qeverisjes së përgjithshme të përcaktuara në planin e miratuar të drejtorisë nr.1138, datë 24.01.2025.

Procesi i vlerësimit të cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm do të shërbejë për identifikimin e mangësive kryesore të sistemit të kontrollit të brendshëm si dhe planifikimin e rekomandimeve të nevojshme për adresimin e tyre. Në përfundim të procesit të vlerësimit, hartohet një projekt-raport dhe raport i detajuar me gjetje dhe rekomandime të cilat duhet të ndiqen në vazhdimësi mbi ecurinë e veprimtarisë së tyre nëpërmjet planit të veprimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK).

Përgjatë datave 02 - 05 Qershor 2025, subjekt i vlerësimit të cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm ishte veprimtaria e Institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, njoftuar nëpërmjet shkresës nr.1138/10, datë 18.03.2025.

Objektivat e vendosura lidhur me këtë vlerësim ishin:

- Verifikimi nga ana e DH/MFKK të gjendjes së zhvillimit të sistemit të kontrollit të brendshëm (KB), duke ekzaminuar bazën dokumentare sipas secilës rubrikë të listës së kontrolleve;
- Vlerësimi i efektivitetit dhe efijencës së këshillave dhe rekomandimeve të adresuara për subjektin e vlerësuar.

Gjetjet dhe konkluzionet kryesore

Nga vlerësimi i cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm rezultoi se:

1. Veprimtaria e Institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë mbështetet në Rregulloren e Brendshme dhe Kodin e Etikës;
2. Institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë vepron gjithashtu në mbështetje të objektivave të përcaktuara në Programin Buxhetor Afatmesëm;

3. Respektohen rregullat mbi përcaktimet e përgjegjësi të nëpunësve të strukturave të ndryshme në institucion, në kuadër të plotësimit të komponentit të mjedisit të kontrollit;
4. Janë marrë masa për zbatimin e procesit të menaxhimit të riskut në institucion;
5. Janë hartuar instrumentat kryesor të menaxhimit për standardizimin e procedurave të institucionit.

Rekomandimet kryesore

Mbështetur në gjetjet e konstatuara, për përmirësimin e situatës në zbatimin e sistemit të KB, rekomandojmë si më poshtë:

1. Rishikimin e manualeve të proceseve të punës dhe gjurmëve të auditimit për të gjithë institucionin, në kuadër të rishikimeve të reja rregullative të fushës, në mbështetje të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar dhe urdhrit nr.4, datë 26.01.2024 “Për miratimin e manualit të menaxhimit financiar dhe kontrollit”;
2. Zhvillimin e mëtejshëm të sistemit të menaxhimit të riskut në përputhje me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, udhëzimin nr.16, datë 20.07.2016 “Për koordinatorin e MFK dhe koordinatorin e riskut në njësitë publike” dhe urdhrin nr.4, datë 26.01.2024 “Për miratimin e manualit të menaxhimit financiar dhe kontrollit”;
3. Përdorimi i instrumentit të delegimit në përputhje me bazat ligjore në fuqi të MFK (ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar dhe udhëzimit nr.4, datë 29.01.2020 “Për delegimin e të drejtave dhe detyrave në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”);
4. Nëpunësi Autorizues mund të monitorojë sistemin e KB nëpërmjet përdorimit të metodologjisë së monitorimit të performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm të njësive publike.

II. HYRJA

Vlerësimi i cilësisë në Institucionin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (Institucioni i ILD) bazohet në nenin 25 dhe 26 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar dhe në Metodologjinë për Vlerësimin e Cilësisë së Sistemit të Kontrollit të Brendshëm në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.311, datë 23.12.2020, i ndryshuar.

Në përfundim të vlerësimit të mbështetur në listën e kontrollit të miratuar me urdhërin e sipërpërmendur hartohet projekt-raporti i vlerësimit të cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm dhe brenda 10 ditëve pune nga dërgimi i projekt-raportit, niveli i lart drejtues i Institucionit të ILD mund të reagojë në lidhje me rekomandimet paraprake të paraqitura.

Nëse njësia e vlerësuar jep komente në lidhje me gjetjet dhe rekomandimet e paraqitura në projektraport, komentet dhe përgjigjet e drejtuesit të njësisë kur janë të argumentuara, merren parasysh nga vlerësuesi gjatë hartimit të raportit përfundimtar.

Nëse nuk ka asnjë reagim nga institucioni i vlerësuar atëherë konsiderohet i ezauruar ky hap dhe vijohet me dërgimin e raportit përfundimtar.

Informacioni mbështetës për vlerësimin e cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm në Institucionin e ILD bazohet në listën e kontrollit të plotësuar dhe dokumentacionet e paraqitura për secilën pikë, pyetësin e vetë-vlerësimit, planin e veprimit të MFK-së, raportin vjetor për vlerësimin e sistemit të KB nga ana e këtij institucioni.

Vlerësimi nga grupi vlerësues u mbështet në dokumentacionet e sipërcituara.

Nëpërmjet shkresës nr.1138/25, datë 02.07.2025, u dërgua projekt raporti i vlerësimit të cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm në Institucionin e ILD, në vijim të të cilit nuk pati komente.

Sistemi i kontrollit të brendshëm në Institucionin e ILD vlerësohet **efektiv**, me 59 pika të plotësuara nga lista e kontrollit të shoqëruar me dokumentacion justifikues.

III. METODA E VLERËSIMIT

Vlerësimi i cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm është i mbështetur në Metodologjinë për Vlerësimin e Cilësisë së Sistemit të Kontrollit të Brendshëm në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme dhe realizohet përmes vlerësimit të efektivitetit të këtyre sistemeve përkatësisht në: efektiv, pjesërisht efektiv, ose joefektiv:

- Sistemi i Kontrollit të Brendshëm do të konsiderohet **efektiv**, nëse nuk janë zbuluar asnjë ose janë zbuluar shumë pak dobësi dhe mangësi të zbatimit të sistemit të kontrollit të brendshëm.
- Sistemi i Kontrollit të Brendshëm do të konsiderohet **pjesërisht efektiv**, nëse dobësitë dhe mangësitë e zbuluara vlerësohen si të mesme dhe / ose të ulta dhe nuk janë zbuluar dobësi të rëndësishme dhe ngjarje të dëmshme për njësinë në zbatimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.
- Sistemi i Kontrollit të Brendshëm do të konsiderohet **jo efektiv** kur ekziston një mangësi e madhe në lidhje me funksionimin e një komponenti ose parimi përkatës, ose në lidhje me komponentët që veprojnë së bashku në një mënyrë të integruar për të gjithë njësinë dhe kjo mangësi ndikon direkt në moszbatimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

Në vlerësimin e njësive të qeverisjes së përgjithshme merren në konsideratë:

- Lista e kontrollit;
- Evidencat mbështetëse;
- Pyetësi i vetë-vlerësimit;

- Raporti vjetor i kontrollit të brendshëm;
- Vlerësimi i performancës sipas indikatorëve;
- Plani i veprimit të MFK;
- Gjetjet e AB dhe KLSH për fushën;
- Vlerësimin e mëparshëm (nëse ka) sipas kësaj metodologjie për njësitë e qeverisjes së përgjithshme të vlerësuara.

Vlerësimi i përgjithshëm i sistemit të kontrollit të brendshëm llogaritet si më poshtë, në mbështetje të 17 parimeve për 5 komponentët COSO të MFK-së:

1. 71%-100% të përgjigjeve mbi listën e kontrolleve vlerësohen të sakta dhe të plotë-efektiv;
2. 41%-70% të përgjigjeve mbi listën e kontrolleve vlerësohen të sakta dhe të plotë-pjesërisht efektiv;
3. 0-40% të përgjigjeve mbi listën e kontrolleve vlerësohen të sakta dhe të plotë-jo efektiv.

Për sa më sipër, nëse njësi që do të vlerësohet rezulton me 48-68 pyetje të plotësuara në bazë dokumentare sipas listës së kontrollit, do të cilësohet me një sistem të KB efektiv. Nëse rezulton me 28-47 pyetje të plotësuara në bazë dokumentare sipas listës së kontrollit, do të cilësohet me një sistem të KB pjesërisht efektiv dhe 0-27, sistem të KB jo efektiv.

Informacionet përkatëse të vlerësimit përfshihen në Raportin Vjetor mbi Funksionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në Njësitë e Qeverisjes Publike.

IV.GJETJET

Vlerësimi i cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm në Institucionin e ILD u mbështet në listën e kontrollit dhe dokumentacionet që e shoqërojnë atë, sipas parimeve përkatëse për secilin komponent të Modelit COSO.

4.1 MJEDISI I KONTROLLIT

Mjedisi i kontrollit i jep tonin njësisë, duke influencuar vetëdijen kontrolluese të punonjësve. Ai përbën themelin ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm, pasi ai ngre strukturën dhe vendos disiplinën. Faktorët e mjedisit të kontrollit të brendshëm përfshijnë integritetin, vlerat e etikës dhe profesionalizmin e punonjësve të njësisë; filozofinë dhe stilin e punës së titullarit, mënyrën se si drejtuesi shpërndan detyrat dhe ngarkon përgjegjësitë apo si organizon dhe zhvillon punonjësit në njësi, si dhe përkushtimin dhe orientimet që jep bordi i menaxherëve.

Parimet që përfshihen në këtë komponent janë:

Parimi 1 - Njësia Publike demonstron angazhim për integritet dhe vlerat etike.

Parimi 2 - Titullari / Bordi apo Këshilli i Drejtuesve demostrojnë pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje.

Parimi 3 - Titullari / Nëpunësi Autorizues (NA) krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë.

Parimi 4 - Njësia publike demonstron angazhim në realizimin e kompetencave.

Parimi 5 - Njësia publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale.

Rezultoi se:

1. Struktura organizative e Institucionit të ILD është miratuar me vendimi të Kuvendit nr.28, datë 19.06.2020 “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Institucionit të ILD”, i ndryshuar, me vendim 85/2020 dhe 10/2023;
2. Dokumenti bazë në të cilin mbështetet veprimtaria e institucionit është “Rregullorja e brendshme e organizmit dhe funksionimit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, miratuar me urdhër nr.119, datë 12.07.2021;
3. Institucioni ka të miratuar Kodin e Etikës me urdhër nr.56, datë 07.07.2022, “Për miratimin e rregullave të etikës dhe sjelljes pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, si një dokument më vete;
4. Evidentohet “Rregullorja për parandalimin e konfliktit të interesave dhe për deklarimin e pasurive në ushtrimin e funksioneve publike në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë miratuar me urdhër nr. 64, datë 25.09.2020 dhe “Rregullorja për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, miratuar me urdhër 140, datë 18.10.2021;
5. Institucioni vepron në bazë të PBA 2023-2025, ku me shkresën nr.547/2, datë 29.04.2022 janë dërguar në Ministrinë e Financave, kërkesat buxhetore shoqëruar me relacionin përkatës. Gjithashtu në lidhje me PBA 2024-2026 evidentohet që me shkresën nr.784/1, datë 28.04.2023 janë dërguar në Ministrinë e Financave kërkesat buxhetore shoqëruar me relacionin shpjegues;
6. Institucioni ka miratuar me urdhër nr.122, datë 06.11.2023 “Planin e Integritetit të Zyrës së ILD për vitet 2023-2025”. Gjithashtu evidentohet urdhër nr.122/1, datë 27.12.2023 “Për mënyrën e monitorimit dhe zbatimit të planit të integritetit në institucion”;
7. Në lidhje me rekrutimet, ILD si një institucion i pavarur kushtetues, procedurat e rekrutimit për pozicionet pjesë e shërbimit civil i zhvillon vetë në mbështetje të kuadrit ligjor në fuqi (ligji nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar). Vendet vakante publikohen në faqen zyrtare të institucionit, sipas procedurës përkatëse. Kriteret janë bazuar në përshkrimet e punës për pozicionet respektive. Evidentohet një praktikë shpallje me shkresën nr.3389/1, datë 30.12.2024 dërguar Shërbimit Kombëtar të Punësimit;
8. Institucioni ndërvepron në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA). ILD identifikon dhe vlerëson nevojat për trajnim nga të gjitha strukturat e saj dhe ka dërguar pranë ASPA shkresën nr.2831/1, datë 11.11.2024 “Planifikim i nevojave të trajnimit për vitin 2025 për ILD. Referohet se janë trajnuar

punonjësit/nëpunësit e të gjitha niveleve me trajnime të ofruara nga ASPA, Shkolla e Magjistraturës dhe ekspertë të huaj (nuk evidentohen certifikatat me bazë dokumentare);

9. Në lidhje me delegimet, evidentohet urdhër nr.123, datë 28.07.2021 “Për delegimin e kompetencës të Sekretari i Përgjithshëm, për nënshkrimin e dokumenteve administrative që dalin nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”;
10. Grupi i Menaxhimit Strategjik është miratuar me urdhër nr.28, datë 11.03.2025. Evidentohet me bazë dokumentare procesverbali i takimit të GMS, datë 23.04.2025 për miratimin e kërkesave buxhetore të ILD (PBA 2026-2028, Faza I);
11. Në institucion me urdhrin e brendshëm nr.119, datë 31.12.2024 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është ngritur dhe funksionon Njësia Përgjegjëse për Sinjalizimin e Brendshëm;
12. Gjithashtu janë miratuar “Rregullorja e brendshme për hetimin administrativ të kërkesës së sinjalizuesit dhe mbrojtjes nga hakmarrja në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, me urdhër nr.102, datë 14.06.2021 dhe “Rregullorja për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e konfidencialitetit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë” me urdhrin nr.103, datë 14.06.2021;
13. Çdo nëpunës i institucionit ka përshkrimin e punës të miratuar, gjithashtu përshkrimet janë pjesë e Rregullores së Brendshme në ILD;
14. Vlerësimet e performancës kryhen periodikisht çdo 6 muaj, nëpërmjet formularëve të vlerësimeve periodike të punës në zbatim të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe YKM nr.109, datë 26.02.2014 “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, i ndryshuar.

4.2 MENAXHIMI I RISKUT

Menaxhimi i Riskut është procesi i identifikimit, vlerësimit, kontrollit dhe monitorimit të atyre ngjarjeve ose situatave potencialisht të dëmshme për arritjen e objektivave të të gjithë njësisë publike dhe konceptohet për të dhënë garanci të arsyeshme se këto objektiva do të arrihen.

Parimet që përfshihen në këtë komponent janë:

Parimi 6 – Specifikimi i objektivave të përshtatshëm.

Parimi 7 – Identifikimi dhe analiza e risqeve.

Parimi 8 – Mundësia e riskut të mashtrimeve.

Parimi 9 – Identifikimi dhe analiza e ndryshimeve të rëndësishme.

Rezultoi se:

1. Institucioni i ILD ka miratuar Regjistrin e Riskut për vitin 2024, të konsoliduar për gjithë institucionin (dokumenti nr.3401, datë 31.12.2024);
2. Në institucionin e ILD është ngritur Grupi i Menaxhimit të Riskut me urdhër nr.147, datë 29.12.2023;

3. Funksioni për koordinatorin e menaxhimit financiar dhe kontrollit nuk është deleguar;
4. Evidentohet dokumenti “Strategjia e menaxhimit të riskut të Zyrës së ILD dhe plani i masave për minimizimin e risqeve për vitet 2023-2025”, miratuar me urdhër nr.146 dt.29.12.2023.

4.3 AKTIVITETET E KONTROLLIT

Aktivitetet e kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet që synojnë reduktimin e risqeve në mënyrë që të arrihen qëllimet dhe objektivat e njësisë dhe të nxisin zbatimin e vendimeve të drejtuesve. Në vendosjen e aktiviteteve të kontrollit, titullarët e njësive duhet të marrin parasysh përfitimet që priten prej tyre, si dhe kostot për futjen dhe zbatimin e tyre. Aktivitetet e kontrollit duhet të integrohen tek proceset dhe sistemet, në momentin që këto procese dhe sisteme krijohen. Futja e aktiviteteve të kontrollit në një fazë të mëvonshme është më e kushtueshme dhe më pak efikase.

Parimet që përfshihen në këtë komponent janë:

Parimi 10 – Përzgjedhja dhe zhvillimi i aktiviteteve të kontrollit.

Parimi 11 – Zgjedhja dhe zhvillimi i aktiviteteve të përgjithshme të kontrollit mbi teknologjinë.

Parimi 12 –Vendosja e aktiviteteve të kontrollit përmes politikave dhe procedurave.

Rezultoi se:

1. Në lidhje me proceset e punës, evidentohet urdhër nr.167, datë 29.12.2021 "Për miratimin e hartës/listës së proceseve kryesore të punës në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Referohet se për vitin 2024 është parashikuar rishikimi i këtij dokumenti;
2. Evidentohet të jetë miratuar dokumenti gjurmëve standarte të auditimit për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, me urdhër nr.168, datë 29.12.2021;
3. Në lidhje me procedurat dhe rregullat për ruajtjen dhe përdorimin e arkivimit të dokumentacionit ILD vepron në mbështetje të ligjit nr.9154 datë 06.11.2003 “Për arkivat”, i ndryshuar. Evidentohet urdhër nr.137/1, datë 15.11.2021 “Për miratimin e listës së dokumenteve me afatet e ruajtjes në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe lista me dokumentet bashkëlidhur. Gjithashtu urdhër 98, datë 12.11.2024 “Për ngritjen e Komisionit për Inventarizimin e Aktiveve të institucionit të ILD”. Praktika shoqërohet me procesverbalin dhe relacionin “Mbi përfundimin e inventarizimit fizik të aktiveve në ILD”; që Komisioni për Inventarizimin e Aktiveve e ka raportuar në përfundim me memo 2964/1, datë 10.01.2025 te Sekretari i Përgjithshëm;
4. Gjithashtu institucioni i ILD ka vendosur në dispozicion regjistrin e aktiveve për vitin 2024. Evidentohet rregullore “Për menaxhimin e aktiveve në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, miratuar me urdhër nr.160, datë 13.12.2021;
5. Institucioni i ILD ka në strukturë Sektorin e Teknologjisë së Informacionit. Evidentohet urdhër nr.107, datë 16.12.2024 “Për miratimin e regjistrit të riskut për

sistemet e teknologjisë së informacionit dhe manualit për masat e sigurisë së sistemeve të teknologjisë së informacionit për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, si edhe “Rregullorja për administrimin dhe përdorimin e sistemit të menaxhimit të ankesave dhe dokumenteve të procedurës hetimore (SMAD) pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, miratuar me urdhër nr.59, datë 15.07.2021.

4.4 INFORMACIONI DHE KOMUNIKIMI

Komponenti i katërt i kontrollit të brendshëm ka të bëjë me çështjet e informacionit dhe të komunikimit. Komunikimi është shkëmbimi i informacioneve të dobishme ndërmjet punonjësve të të gjitha niveleve të njësisë publike, si horizontalisht dhe vertikalisht, dhe ndërmjet njësive publike për të mbështetur vendimet dhe për të koordinuar aktivitetet.

Informacioni duhet t'i komunikohet menaxhimit dhe punonjësve të tjerë, në formën dhe brenda një harku kohor, që i ndihmon ata për të kryer përgjegjësitë e tyre. Komunikimi me taksapaguesit, furnitorët e shërbimeve, rregullatorët dhe palët e tjera të jashtme është gjithashtu thelbësor për kontrollin e brendshëm efektiv. Informacioni është baza e komunikimit që nevojitet për kryerjen efektive të detyrave të ngarkuara.

Rëndësia e kanaleve të informacionit dhe komunikimit me të cilat informacionet transferohen mund të shihet drejtpërdrejt në procesin e vendimmarrjes. Cilësia e një vendimi të marrë është e kushtëzuar nga cilësia e informacionit në drejtim të kohës, përshtatshmërisë, saktësisë dhe disponueshmërisë.

Parimet që përfshihen në këtë komponent janë:

Parimi 13 - Marrja, gjenerimi dhe përdorimi i informacionit përkatës cilësor.

Parimi 14 - Komunikimi i brendshëm.

Parimi 15 - Komunikimi i jashtëm.

Rezultoi se:

1. Procesi i komunikimit në institucion funksionon duke u realizuar nëpërmjet shkresave dhe e-mail-eve zyrtare me institucionet e tjera, duke përdorur linjat e brendshme të komunikimit dhe nëpërmjet njoftimeve në faqen zyrtare të institucionit;
2. Në lidhje me treguesit financiar, referuar faqes së web dhe në bazë të materialeve të vendosura në dispozicion nga institucioni evidentohen rregullisht raportime financiare si: detajimi i investimeve dhe shpenzimeve korrente të buxhetit, si dhe raportet e monitorimit për zbatimin e buxhetit për periudhat katërmujore, tetëmuajore apo vjetore (të shoqëruara me shkresat shoqëruese përkatëse dhe të dërguara si informacion në Ministrinë e Financave);

4.5 MONITORIMI

Monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të njësisë, i cili synon të ofrojë garanci të arsyeshme se aktivitetet e kontrollit funksionojnë sipas qëllimit për të cilin janë krijuar dhe mbeten efëiente me kalimin e kohës. Në kryerjen e monitorimit, titullari i njësisë, nëpunësi autorizues dhe menaxherët e tjerë, duhet t'i kushtojnë vëmendje gjendjes së menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe objektivave të arritura.

Parimet që përfshihen në këtë komponent janë:

Parimi 16 - Përzgjedhja, zhvillimi dhe kryerja e vlerësimeve të vazhdueshme dhe / ose të veçanta.

Parimi 17 - Vlerësimi dhe komunikimi i mangësive.

Rezultoi se:

1. Evidentohen plane vjetore të punës për objektivat për vitin 2024, nga sektorë të ndryshëm të institucionit të ILD. Gjithashtu raportime pune vjetore, si dhe informacione mujore për detyrat e realizuara sipas afateve (të cilat raportohen te Sekretari i Përgjithshëm të institucionit të ILD);
2. Me urdhër 134, datë 20.12.2023 është miratuar dokumenti i Planit Strategjik dhe Planit të Veprimit për ILD për vitet 2023 – 2025". Gjithashtu urdhër nr.134/1, datë 29.12.2023 "Për mënyrën e zbatimit, monitorimit dhe raportimit të planit strategjik dhe planit të veprimit të Zyrës së ILD 2023-2025", ku në vijim institucioni ka hartuar Raportin e Monitorimit mbi zbatimin e Planit Strategjik dhe Planit të Veprimit për ILD për periudhën Janar - Qershor 2024, si dhe Raportin Vjetor për punën e Zyrës së ILD për vitin 2024;
3. Evidentohet të jetë hartuar "Plani i inspektimeve për vitin 2025 në ILD" me vendim nr.05, date 31.01.2025;
4. Institucioni ka dërguar në Ministrinë e Financave raportimin vjetor 2023 me shkresën nr.3355/2, datë.23.02.2024 dhe raportimin vjetor 2024 me shkresën nr.3104/3, datë 27.02.2024 (deklaratën dhe raportin për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm, së bashku me pyetësin e vetë-vlerësimit si dhe planin e veprimit të MFK për vitin);
5. Në strukturën e Institucionit të ILD, nuk ka Njësi të Auditimit të Brendshëm. Institucioni evidentohet të jetë kontrolluar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, i cili ka dërguar "Raportin përfundimtar mbi auditimin financiar të ushtruar në ILD për periudhën 01.01.2021 deri 31.12.2023". Gjithashtu evidentohet që institucioni të ketë miratuar me shkresën nr.172/12, datë 25.06.2024 "Planin e Masave për zbatimin e rekomandimeve të raportit përfundimtar të KLSH mbi auditimin e ushtruar në ILD".

IV. REKOMANDIMET

Në mbështetje të gjetjeve të përcituara, rekomandojmë sa më poshtë vijon:

1. Të rishikohet rregullorja e brendshme e institucionit në bazë të ndryshimeve të reja strukturore;
2. Të përpunohen instrumentat e reja të menaxhimit të riskut (planet e menaxhimit të riskut dhe plani i masave të trajtimit të risqeve), për të gjithë institucionin, sipas përcaktimeve rregullative të reja të fushës referuar ndryshimeve në ligjin e menaxhimit financiar dhe kontrollin (ligji nr.14/2023) dhe manualit të menaxhimit financiar dhe kontrollit miratuar me urdhër të Ministrit të Financave nr.4, datë 26.01.2024 dhe udhëzimit nr.16, datë 31.12.2024 “Për përgjegjësitë dhe detyrat lidhur me koordinimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe funksionimin e grupit të menaxhimit të risqeve në njësitë publike”;
3. Në kuadër të përmirësimit të proceseve dhe procedurave ekzistuese të punës, rekomandojmë të rishikohen listat e proceseve të punës, duke marrë trajtën e manualeve të proceseve të punës dhe konsolidimin e tyre në një dokument të vetëm sipas ndryshimeve në aktet e përmendura në pikën 2 të kësaj rubrike;
4. Gjatë takimeve të Grupit të Menaxhimit Strategjik të trajtohen problematika që lidhen me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), duke e shtrirë fokusin në vlerësimin e gjendjes së sistemit të kontrollit të brendshëm dhe ndërmarrjen e masave të nevojshme për përmirësimin e këtij sistemi;
5. Të përdoret më shpesh instrumenti i delegimit, sipas ligjit të menaxhimit financiar dhe kontrollit duke mbajtur në vëmendje edhe orientimet në udhëzimin e Ministrit të Financave nr.4, datë 29.01.2020 “Për delegimin e të drejtave dhe detyrave në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”;
6. Të gjitha rekomandimet e sipërpërmendura duhet të përfshihen në planin e veprimit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit për vitin në vijim, pasi ky plan do të përbëjë bazën e punës për ndjekjen e procedurave në të ardhmen dhe duhet të dërgohet me shkresë në Ministrinë e Financave.

MINISTRI

Petrit Malaj

NË MUNGESË DHE URDHËR

ZËVENDËSMINISTËR

Erjona Bejleri

